

LIGJ
Nr. 173/2014

PËR DISIPLINËN NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe rregullave të hollësishme të sjelljes e të etikës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, i kategorive dhe llojeve të shkeljeve, masave disiplinore, si dhe i autoriteteve kompetente për dhënien e tyre.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandim-kontrollit në Forcat e Armatosura për të siguruar përmbushjen e misionit të tyre kushtetues.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për fushën e veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Subjektet

(shtuar fjalë me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

Subjektet, sipas këtij ligji, janë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, kursantët, studentët, si dhe ushtarakët në rezervë kur janë në shërbim ushtarak për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak.

Neni 5

Juridiksioni territorial

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë, kur ata janë dërguar me mision, shërbim, stërvitje të përbashkët, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe.

Neni 6 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Epror” është ushtaraku, i cili, në bazë të gradës apo funksionit, ushtron autoritet mbi ushtarakët vartës.
2. “Vartës” është ushtaraku, i cili është nën autoritetin e një personi që ka gradë apo funksion më të lartë.
3. “Dhënie e informacionit” është dhënia, përhapja, transmetimi i informacionit, me dashje ose nga pakujdesia, të tretëve, në formë elektronike, shkresore ose verbale.
4. “Situatë emergjente” është situata e shkaktuar nga faktorë natyrorë, industrialë ose nga veprimet e njerëzve, e cila mund të sjellë ose ka sjellë dëmtim të menjëhershëm e të rëndë për jetën, shëndetin e njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë ose ambientit, duke prishur normalitetin e jetës së komunitetit dhe të shërbimeve të Forcave të Armatosura.
5. “Shkelje disiplinore” është çdo veprim, mosveprim, sjellje apo qëndrim, që bie në kundërshtim me këtë ligj, i kryer nga ushtarakët e Forcave të Armatosura.
6. “Masë disiplinore” është masa me karakter ndëshkues ose parandalues, e përcaktuar në këtë ligj, që merret ndaj ushtarakut nga autoritetet përgjegjëse kur ai kryen shkelje disiplinore.

Neni 7

Autoritetet përgjegjëse

(ndryshuar fjalia e fundit në shkronjën “b”, shtuar fjalë në shkronjat “c” e “ç”, shtuar një paragraf në shkronjën “c” të pikës 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore ndaj ushtarakëve të Forcave të Armatosura, me përjashtim të atyre me grada madhore, janë:

a) Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, vetëm për dhënien e masave shumë të rënda disiplinore për të gjithë oficerët e Forcave të Armatosura;

b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, vetëm për masat e lehta dhe të rënda për:

i) ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturave, me drejtues civilë, të varësisë së tyre të drejtpërdrejtë;

ii) ushtarakët që shërbejnë në shtabet e NATO-s, në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare;

iii) zëvendëskomandantët, shefat e shtabeve të komandave të forcave dhe strukturave mbështetëse dhe strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me përjashtim të atyre të përcaktuara në paragrafin e dytë të shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni.

c) komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe ato të strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për masat e lehta dhe të rënda, për ushtarakët në varësi të tyre në nivel batalioni, drejtuesi ushtarak në nivel njësie kryesore/njësie bazë në institucionet arsimore ushtarake e lart, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike;

Komandantët e Forcave dhe strukturave mbështetëse, me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor, për masat shumë të rënda “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Ulje në pagë” për tetarët dhe

nëntetarët, si dhe për ushtarët me grada “Ushtar I” deri “Ushtar IV” në varësi të tyre.

ç) komandantët në nivel batalioni, drejtuesi ushtarak në nivel njësie kryesore/njësie bazë në institucionet arsimore ushtarake, për masat e lehta dhe të rënda, për ushtarakët në varësi të tyre, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike;

d) komandantët në nivel kompanie dhe toge, për masat e lehta, për ushtarakët në varësi të tyre, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike.

2. Ndaj oficerëve me grada madhore mund të jepen vetëm masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “ç” dhe “dh”, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

3. Autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra dhe lirim nga Forcat e Armatosura”, për oficerët me gradë madhore është Presidenti i Republikës. Propozimi për dhënien e kësaj mase disiplinore Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura bëhet nga Kryeministri, ndërsa për oficerët e tjerë me grada madhore bëhet nga Ministri i Mbrojtjes.

4. Autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Ulje e pagës” për oficerët me grada madhore është Ministri i Mbrojtjes me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor.

Neni 8

Komisioni disiplinor

1. Në strukturat në nivel batalioni e lart ngrihen dhe funksionojnë komisionet disiplinore, që kanë në përbërje jo më pak se tre oficerë të strukturës përkatëse, me grada të njëjta ose më të larta se ato të ushtarakut, ndaj të cilit procedohet disiplinarisht.

2. Nuk mund të jetë pjesë e komisionit disiplinor autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore, si dhe personi që ka konstatuar shkeljen apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej saj.

3. Komisionet disiplinore janë përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve nga ushtarakët e ndëshkuar me masa të rënda disiplinore. Në përfundim të shqyrtimit komisioni disiplinor vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ndryshimin ose shfuqizimin e saj. Vendimi i komisionit disiplinor miratohet nga autoriteti përgjegjës i një shkalle më të lartë se ai që ka dhënë masën, ndaj së cilës është bërë ankim.

4. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e komisioneve disiplinore përcaktohen me rregullore të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 9

Komisioni i Lartë Disiplinor

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Në Shtabin e Përgjithshëm, Komandat e Forcave dhe strukturat mbështetëse të Forcave të Armatosura ngrihet dhe funksionon Komisioni i Lartë Disiplinor, që ka në përbërje jo më pak se pesë oficerë me grada të njëjta ose më të larta se ato të ushtarakut, ndaj të cilit procedohet disiplinarisht. Në rast të procedimit ndaj një ushtaraku me gradë madhore, përbërja e komisionit është jo më pak se tre oficerë me grada madhore.

2. Nuk mund të jetë pjesë e Komisionit të Lartë Disiplinor autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore, si dhe personi që ka konstatuar shkeljen apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej saj.

3. Komisioni i Lartë Disiplinor është përgjegjës për shqyrtimin e procedimeve disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore, të kryera nga ushtarakët e Forcave të Armatosura. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni i Lartë Disiplinor vendos dhënien ose jo të masës disiplinore.

4. Vendimi i Komisionit të Lartë Disiplinor miratohet nga autoriteti përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.

5. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e Komisionit të Lartë Disiplinor përcaktohen me rregullore të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU II SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 10

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

Shkeljet disiplinore klasifikohen:

- a) të lehta;
- b) të rënda;
- c) shumë të rënda.

Neni 11

Shkelje disiplinore të lehta

(ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Shkelje disiplinore të lehta janë:

- a) veprimi në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve ose të materialeve shkresore, elektronike dhe filmike;
- b) mosrespektimi i rregullave të nderimit sipas shkallës hierarkike;
- c) mosdeklarimi i përdorimit të barnave për arsye mjekësore, që krijojnë efekte në sjelljen ose aftësitë fizike të tij;
- ç) publikimi i paautorizuar në rrjetet sociale i pamjeve personale ose i çdo efektivit të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak, simbole dhe mjete teknike ushtarake;
- d) mosrespektimi i orarit të punës;
- dh) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura për qëllime private, gjatë apo pas kryerjes së detyrës, përjashtuar rastet kur është i autorizuar për këtë gjë;
- e) përdorimi i automjeteve të Forcave të Armatosura pa dokumentacionin përkatës;
- ë) përdorimi i paautorizuar i sendeve personale dhe ushtarake të ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;
- f) përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private;
- g) mosraportimi i shkeljes disiplinore;
- gj) lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës ose mjetit tokësor, detar, ajror nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale;
- h) përdorimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;
- i) pranimi i dhuratave ose i ndonjë përfitimi nga vartësit apo persona të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- j) mosdhënia e ndihmës ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ata kanë nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet;
- k) shkrepija e armës nga pakujdesia, e cila nuk shkakton dëme materiale ose lëndime njerëzore;
- l) mosmirëmbajtja dhe/ose dëmtimi i armës, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura nga pakujdesia, që shkakton humbjen e përkohshme të gatishmërisë teknike të tyre.

2. Kryerja e shkeljes së tretë të lehtë disiplinore, pasi ushtaraku aktiv ka marrë dy masa

disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet e rënda, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 12

Shkelje disiplinore të rënda
(ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Shkelje disiplinore të rënda janë:

a) kryerja e riteve fetare me uniformë në institucionet fetare, jashtë ambienteve të Forcave të Armatosura;

b) publikimi ose dhënia në medie e informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, si dhe shpërndarja e dokumenteve zyrtare të paklasifikuara, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

c) shprehja e kritikave publike ndaj Forcave të Armatosura, në formë shkresore, elektronike ose verbale, që cenon imazhin e institucionit apo personalitetin e ushtarakëve të tjerë të Forcave të Armatosura;

ç) fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore ose elektronike;

d) dhënia me dashje e informacionit të gabuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

dh) shkelja me qëllim e rregullave të mbajtjes, të mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe të përdorimit të armatimit, të municionit, të teknikës, të pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura;

e) mbajtja dhe përdorimi i armës nga ushtaraku i Forcave të Armatosura në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

ë) mbajtja e armëve individuale private, me leje, në ambientet ushtarake;

f) veprime, qëndrime ose shfaqje diskriminuese në bazë etnie, fetare, race, krahine, bindjeje politike, filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore;

g) përdorimi i pijeve alkoolike gjatë punës/shërbimit apo në rastet kur është me uniformë, me përjashtim të aktiviteteve zyrtare;

gj) dhënia e uniformës me shenjat dhe simbolet dalluese ushtarake, e dokumentit të Forcave të Armatosura ose e pajisjeve të tjera ushtarake personave të tjerë;

h) mbajtja e uniformës ushtarake në lokale nate, kazino, lojëra fati dhe në ambiente të tjera të ngjashme me këto;

i) mungesa, mosparaqitja në shërbim/punë ose largimi nga vendi i shërbimit/punës, pa arsye të justifikuar deri në 5 (pesë) ditë për ushtarët dhe deri në 7 (shtatë) ditë për oficerët dhe nënoficerët;

j) mosparaqitja në punë ose në shërbim jashtë orarit të përcaktuar, kur i kërkohet nga eprorët e tij, pa arsye të justifikuar;

k) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;

l) ngacmimet seksuale në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale ose fizike të një natyre seksuale, të kryera gjatë ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbëjnë vepër penale;

ll) shkelja e rregullave të shërbimit, kur nuk përbën vepër penale;

m) rezistenca ndaj procedimit disiplinor ose refuzimi i kryerjes së masave disiplinore;

n) përkrahja ose ndihma në kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në këtë ligj ose pengimi apo parandalimi për kapjen, gjykimin a dënimin e ushtarakut, i cili ka kryer një shkelje të dënueshme nga ky ligj;

nj) mosmarrja e masave të nevojshme për ndërprerjen e shkeljes disiplinore që po kryhet nga vartësit e tij dhe/ose për parandalimin e pasojave të mëtejshme që mund të vijnë prej saj;

o) kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës;

p) dëshmia e rreme gjatë procedimit disiplinor;

q) mosraportimi i përdorimit të armës së zjarrit;

r) mosrespektimi i orarit të punës më shumë se një herë brenda një periudhe njëmuajore;

rr) ushtrimi i presionit ndaj vartësve për përfitime personale, kur nuk përbën vepër penale;

s) prishja e qetësisë në njësi ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale;

sh) moszbatimi i detyrave të dhëna nga eprori i drejtpërdrejtë;

t) mbajtja në mënyrë të parregullt, ndryshimi ose keqpërdorimi i uniformës dhe shenjave ushtarake;

th) “Ngacmim” në çdo formë sjelljeje të padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues ose fyes për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë;

u) veprime me dashje, të cilat çojnë në paaftësi fizike të vetë ushtarakut, me qëllim shmangien nga detyrat e ngarkuara.

2. Shkeljet disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “k” dhe “l” të pikës 1 të këtij neni, të kryera gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes, misionit jashtë vendit ose të kryera nga oficerë me grada madhore, kategorizohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe masat përkatëse jepen sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

3. Kryerja e shkeljes së tretë të rëndë disiplinore, pasi ushtaraku ka marrë dy masa disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet shumë të rënda, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 13

Shkelje disiplinore shumë të rënda

(ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

Shkelje disiplinore shumë të rënda janë:

a) mbështetja e fushatës së një partie ose organizate politike apo e një anëtari të një partie politike ose të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë fizikisht ose duke kontribuar financiarisht;

b) ndihma, përkrahja ose pjesëmarrja në aktivitete të organizatave politike, fetare ose jofitimprurëse gjatë orarit të punës, në vendin e punës ose në mjetet ushtarake, si dhe në rastet kur mban uniformën ushtarake ose shenja të saj;

c) lejimi i personave nga organizata politike, fetare ose çdo organizatë tjetër jofitimprurëse të bëjnë propagandë në ambientet e Forcave të Armatosura dhe në mjetet që ata disponojnë;

ç) përdorimi, shpërndarja ose vendosja në mjetet ose në ambientet ku shërbejnë Forcat e Armatosura e simboleve apo reklamave të organizatave politike apo shoqërore, me përjashtim të atyre me karakter humanitar;

d) ushtrimi i funksioneve ose mospërmbushja e detyrave që sjellin cenim të operacionalitetit, të gatishmërisë dhe të sigurisë në Forcat e Armatosura;

dh) organizimi, nxitja ose pjesëmarrja në grevë;

e) përdorimi i substancave të paligjshme dhe i lëndëve narkotike, kur nuk përbën vepër penale;

ë) dhënia ose mundësimi i dhënies së informacioneve me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme, personave të paautorizuar ose medias, kur nuk përbën vepër penale;

f) ngacmimet në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale ose fizike të një natyre seksuale, të kryera nga eprori ndaj vartësit ose ndaj ushtarakut me gradë më të ulët gjatë ose jashtë orarit të punës;

g) organizimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;

gj) ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune, sjellja fyese ose kërcënuese ndaj një personi tjetër, kur kjo ushtrohet nga oficerët aktivë me grada të larta ose madhore të Forcave të Armatosura ose kur kryhet ndaj eprorit të drejtpërdrejtë në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;

h) refuzimi i zbatimit të urdhrat ose një vendimi të ligjshëm të dhënë nga eprori;

i) mosmarrja e masave të duhura të organizimit dhe të sigurisë nga drejtuesit e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura, kur kjo ka sjellë pasoja të rënda materiale;

j) përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin dhe/ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët, për çfarëdo arsyeje, pa dijeninë e tyre, kur nuk përbën vepër penale dhe përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 14

Masat disiplinore

(shuar shkronja “ç” e pikës 1 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje të lehta, janë:

a) “Qortimi”, e cila është masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura për shkelje të lehta të disiplinës ushtarake;

b) “Detyra shtesë”, e cila është masa për të kryer detyra të tjera, pa përfshirë punët fizike, që u jepen oficerëve deri në gradën kapiten, si ndëshkim, përveç detyrës së zakonshme. Për nënoficerët dhe ushtarët mund të jepen dhe detyra shtesë me punë fizike. Ushtarakut nuk i jepen detyra shtesë, të cilat përbëjnë rrezikshmëri për jetën dhe shëndetin e tij ose që cenojnë dinjitetin e tij;

c) “Punë jashtë orarit”, e cila është masa që u jepet ushtarakëve të Forcave të Armatosura për t’u kryer mbas orarit zyrtar të punës, por jo më shumë se 4 orë dhe pa të drejtë page. Ky dënim nuk mund të jepet në fundjavë dhe në ditët e festave zyrtare. Puna konkrete dhe mënyra e kryerjes së saj përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për dhënien e masës.

ç) “Stërvitje disiplinuese”, e cila është masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura brenda natyrës së elementeve të stërvitjes, të tilla si: vrapim, pompa, palosje ose ndonjë stërvitje tjetër të përshtatshme gjatë shërbimit. Kjo masë jepet ndaj ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve deri në gradën kapiten.

2. Masat disiplinore, që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje të rënda, janë:

a) “Vërejtje me shkrim”, e cila është masa me shkrim drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura;

b) “Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar”, e cila është masa e kufizimit të lëvizjes fizike të një ushtaraku, brenda kufijve të përcaktuar të repartit, me urdhër të shkruar, por jo më shumë se 72 orë. Ushtarakut, të cilit i jepet kjo masë, kryen të gjitha detyrat ushtarake, përveç rasteve kur urdhërohet ndryshe;

c) “Ndalim disiplinor”, e cila është masa e kufizimit fizik të një ushtaraku brenda mjedisve të përcaktuara për këtë qëllim, me urdhër të shkruar, por jo më shumë se 72 orë. Ky mjedis mund të jetë një dhomë, tendë ose kabinë në anije. Ushtarakët gjatë ndalimit nuk kryejnë detyra ushtarake, përveç rasteve të situatave emergjente;

ç) “Gjobitje në pagë”, e cila është masa e ndalimit të një pjese të pagës pa të drejtë rimarrjeje. Kjo

sasi nuk mund të tejkalojë 1/4 e pagës neto mujore.

3. Masat disiplinore që jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje shumë të rënda janë:

a) “Vërejtje me paralajmërim”, e cila është masa me shkrim, e motivuar, drejtuar ushtarakut të Forcave të Armatosura për lirim nga Forcat e Armatosura;

b) “Ulje në detyrë”, që është një masë nëpërmjet së cilës ushtaraku emërohet në një detyrë të përcaktuar për t’u ushtruar nga një ushtarak me gradë më të ulët për jo më shumë se një vit;

c) “Ulje e pagës”, që është masë nëpërmjet së cilës ushtaraku do të trajtohet me pagën e deri një grade më të ulët për jo më shumë se një vit;

ç) “Ndalimi për gradim”, e cila është masa që ndalon ushtarakun për të konkurruar për marrjen e gradës së radhës vetëm 1 (një) herë;

d) “Ulje në gradë”, e cila është një masë nëpërmjet së cilës ushtaraku ulet deri në një gradë, për jo më shumë se 1 (një) vit. Në fund të periudhës së zbatimit të masës disiplinore, ushtaraku rimerr gradën e mëparshme, me urdhër të autoritetit përgjegjës;

dh) “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”, e cila është masë ekstreme e dhënë për shkelje shumë të rënda disiplinore.

Neni 15

Raportimi i shkeljeve disiplinore

1. Raportimi për shkeljet disiplinore, të kryera nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, bëhet në repartin, ku ai shërben, nga personeli ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura si dhe nga çdo individ tjetër, që konstaton shkeljen disiplinore.

2. Raportimi bëhet sipas një formati standard, i cili miratohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

KREU III

ECURIA DISIPLINORE

Neni 16

Ecuria disiplinore

1. Me ecuri disiplinore kuptohet gjithë veprimtaria që kryhet, që në momentin e vënies në dijeni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen deri në marrjen e një vendimi për ndëshkimin disiplinor ose mosndëshkimin e tij.

2. Në përcaktimin e masës disiplinore të ushtarakut të Forcave të Armatosura merren parasysh koha, vendi, shkaqet, rëndësia e shkeljes, shkalla e fajësisë, rrethanat lehtësuese e rënduese, si dhe pasojat e shkeljes disiplinore.

3. Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, merr vendim për dhënien ose jo të masës disiplinore brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore. Për raste komplekse, ky afat mund të zgjatet nga autoriteti përgjegjës, por, në çdo rast, jo më shumë se 15 ditë. Zgjatja e afatit bëhet me shkrim dhe i njoftohet edhe ushtarakut, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor.

4. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

Neni 17

Të drejtat e ushtarakut gjatë procedimit disiplinor

1. Me fillimin e ecurisë disiplinore ushtaraku vihet në dijeni, me shkrim, për elementet e procedimit disiplinor të nisur ndaj tij.

2. Ushtaraku, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të dëgjohet nga autoriteti përgjegjës ose komisioni disiplinor përkatës, si dhe të parashtrijë prova dhe fakte në lidhje me pafajësinë e tij.

3. Të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte ushtaraku e ushtron personalisht.

4. Në rastet e procedimeve për shkelje shumë të rënda disiplinore, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte, ushtaraku e ushtron vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ushtarak të zgjedhur prej tij. Nëse nuk është në gjendje të gjejë një përfaqësues, bën kërkesë me shkrim tek autoriteti përgjegjës ose komisioni disiplinor përkatës, i cili i cakton një përfaqësues ushtarak të profilit jurist për mbrojtjen e tij.

Neni 18

Rrethanat lehtësuese

(ndryshuar pika 2 dhe shtuar pikat 3, 4 e 5 me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Rrethana lehtësuese gjatë kryerjes së një shkeljeje disiplinore konsiderohen:

- a) mungesa e përvojës në punë të ushtarakut të Forcave të Armatosura;
- b) kryerja e shkeljes për herë të parë;
- c) vlerësime dhe rezultate të mira në punë;
- ç) sjellja korrekte e ushtarakut.

2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.

3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.

Neni 19

Rrethanat rënduese

(ndryshuar shkronja “gj”, shtuar shkronjat “h”, “i” dhe “j” të pikës 1, ndryshuar pika 2 dhe shtuar pikat 3, 4 e 5, me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Rrethana rënduese gjatë kryerjes së një shkeljeje disiplinore konsiderohen:

- a) kryerja e shkeljes disiplinore në publik;
- b) përsëritja e shkeljes përkatëse ose e shkeljeve të tjera;
- c) ndëshkimi i mëparshëm me masë disiplinore;
- ç) përvoja e punës, të paktën dy vjet, në atë shërbim;
- d) ardhja e pasojave prej shkeljes disiplinore;
- dh) vlerësime dhe rezultate jo të mira në punë;
- e) kryerja në të njëjtën kohë e më shumë se një shkeljeje disiplinore;
- ë) kryerja e shkeljes disiplinore në bashkëpunim;
- f) kryerja e një shkeljeje disiplinore gjatë kohës që është duke vuajtur dënimin për një tjetër shkelje disiplinore;
- g) kryerja e një shkeljeje disiplinore gjatë kohës që është në procedim disiplinor për një shkelje tjetër disiplinore;
- gj) Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes apo misionit jashtë vendit.

h) kryerja e shkeljes disiplinore nga oficerë me grada të larta.

i) kryerja e shkeljes disiplinore në situatë luftar, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

j) kryerja e shkeljes disiplinore gjatë operacioneve ose misioneve brenda vendit.

2. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.

3. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.

4. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me një nga masat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji.

5. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen për oficerët me grada madhore.

Neni 20

Pezullimi disiplinor

1. Pezullimi disiplinor i ushtarakut nis nga momenti i njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore për shkelje të rënda dhe shumë të rënda disiplinore, deri në dhënien e vendimit, me qëllim mospengimin e procedimit disiplinor si dhe parandalimin e kryerjes së shkeljeve të tjera.

2. Pezullimi disiplinor nuk përbën ndëshkim disiplinor.

3. Pezullimi disiplinor jepet me shkrim, rast pas rasti, nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7 të këtij ligji.

4. Në rastë se ecuria disiplinore ka nisur ndaj një ushtaraku me gradë madhore, autoriteti përgjegjës për pezullimin disiplinor është Ministri i Mbrojtjes.

5. Ndaj ushtarakut të Forcave të Armatosura që pezullohet nga detyra, autoriteti përgjegjës mund të vendosë gjatë periudhës së pezullimit një ose më shumë nga kufizimet e mëposhtme:

a) heqjen e së drejtës për të hyrë i pashoqëruar në ambientet e Forcave të Armatosura;

b) heqjen e së drejtës për të mbajtur pajisjet personale të punës;

c) heqjen e së drejtës për të pasur akses në materialet me informacion të klasifikuar.

Neni 21

Parashkrimi i masës disiplinore

1. Masa disiplinore nuk mund t'i jepet një ushtaraku të Forcave të Armatosura, nëse shkelja nuk është zbuluar brenda 12 muajve nga kryerja e saj.

2. Në rast të kryerjes së shkeljeve shumë të rënda disiplinore, masa nuk mund të jepet, nëse nuk është zbuluar brenda 24 muajve nga kryerja e saj.

Neni 22

Ndërprerja e masës disiplinore

1. Masat disiplinore “Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar” dhe “Ndalim disiplinor” mund të ndërpriten nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, kur nga momenti i ekzekutimit të masës ka kaluar jo më pak se një e treta e afatit të shlyerjes së saj.

2. Në urdhrin për ndërprerjen e masës disiplinore, autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, duhet të argumentojë arsyet për heqjen e saj.

Neni 23
Rehabilitimi

(shtuar fjalë në fund të shkronjave "a" e "b" me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

Rehabilitohen:

a) ushtarakët e Forcave të Armatosura, ndaj të cilëve është marrë një masë e lehtë disiplinore, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, dhe që për një periudhë 6-mujore nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër disiplinore. Në përfundim të kësaj periudhe masa disiplinore hiqet nga dosja personale e ushtarakut me urdhër të autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore;

b) ushtarakët e Forcave të Armatosura, ndaj të cilëve është marrë një masë e rëndë disiplinore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 14, të këtij ligji, dhe që për një periudhë 1-vjeçare nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër të rëndë disiplinore. Në përfundim të kësaj periudhe masa disiplinore hiqet nga dosja personale e ushtarakut me urdhër të autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore.

Neni 24
Veprimet procedurale

Veprimet procedurale që nga konstatimi i shkeljes deri në dhënien e vendimit përfundimtar për dhënien ose jo të masës përkatëse nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7, të këtij ligji, përfshirë dhe afatet për përgatitjen e mbrojtjes, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 25
Ankimi për masat disiplinore
(shtuar fjalë në pikën 4me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)

1. Ankimi për masat e lehta disiplinore, të dhëna nga komandantët në nivel toge, kompanie ose batalioni, bëhet tek eprori i drejtpërdrejtë i autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore.

2. Për masat e lehta disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe ato të strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nuk lejohet ankimi.

3. Ankimi për masat e rënda disiplinore, të dhëna nga komandantët në nivel batalioni, bëhet te komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse përkatëse.

4. Ankimi për masat e rënda dhe shumë të rënda disiplinore, të dhëna nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse apo strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bëhet te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Ankimi për masat e rënda dhe shumë të rënda disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

6. Ankimi për masat e dhëna nga Ministri i Mbrojtjes dhe Presidenti i Republikës bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

7. Ankimi në rrugë gjyqësore për masat disiplinore bëhet vetëm pas ezaurimit të ankimit administrativ, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

8. Ankimi administrativ për masat disiplinore bëhet brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për masën e dhënë.

9. Autoriteti përgjegjës, tek i cili bëhet ankimi, merr vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për ankimin.

10. Ankimi administrativ për masat e rënda disiplinore pezullon ekzekutimin e masës deri në

marrjen e vendimit nga autoriteti përgjegjës. Bën përjashtim nga ky rregull ankimi ndaj masës disiplinore të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 14, të këtij ligji.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, 9, pika 5, 15, pika 2, dhe 24 të këtij ligji.

Neni 27

Shfuqizime

Ligji nr. 9183, datë 5.2.2004, “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 28

Aktet nënligjore në fuqi

Aktet nënligjore, të nxjerra para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.12.2014

KRYETARI
Ilir Meta